

RREGULLORE E BRENDSHME E SHKOLLËS

RENDI SHTËPIAK I SHKOLLËS

SELLCË-2024-25

I. Ambienti shkollor

A/ Ambienti i jashtëm :

Për ambientin e jashtëm (oborrin, poligonet sportive, këndet gjelbruese, përkujdesen të gjithë, sidomos nxënësit dhe punëtorët teknik;

Hedhurinat hidhen në vendin e caktuar;

Askush nuk ka të drejte që pa nevojë të vijë, të qëndroj e të shetis në oborrin e shkollës;

Prindërit dhe zyrtarët janë gjithënjë të mirëseardhur në shkollë;

Në oborrin e shkollës, nuk mund të hyj apo të parkohet asnjë automjet,

B/ Ambienti i brendshme

Nxënësit e shkollës, mësimdhënësit dhe punëtorët teknik të shkollës, kanë për detyrë që të përkujdesen për mbajtjen e pastërtisë në të gjitha mjediset e godinës shkollore (mësonjëtoje, zyra, kabinete, koridore etj), të kujdesen për inventarin shkollor, mjetet mësimore, nyjet hidrosanitare etj.

Pastrimi nga punetoret teknik (mirëmbajtësit e higjienës) është i përditshëm. Në fund të javës bëhet pastërimi i përgjithshëm i godinës shkollore (pastrimi me ujë – larja);
Në stinën e dimrit të gjitha lokalet e shkollës ku mësojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre nxënësit dhe mësimdhënësit e shkolles duhet të jenë të ngrohta;

II. Puna Ditore

Procesi mësimor – edukativ në vitin shkollor 2024 / 2025 zhvillohet në dy ndërrime.
Ndërrimi i parë e fillon mësimin në ora **7,30** dhe e përfundon në ora **12, 50 min.** (kl. VI, VII, VIII, IX), Ndërrimi i dytë e fillon mësimin në ora 13, 00 dhe e përfundon në ora 18.00 (kl. I – V).

Ora mësimore zgjatë **40** minuta.

Drejtori i shkollës ,punon nga ora **8,00 e gjerë në ora 16,00.**

Zëvendës drejtori, punon nga ora **10,00 e gjerë në ora 18,00.**

Zyrtari administrativ,punon nga ora **8,00 e gjerë në ora 16,00**

Punëtorët ndihmës, punojnë sipas ndërrimeve. **Ndërrimi i parë 6,00 – 13,00, ndërrimi i dytë nga ora 13,00 – 19,00, në punë duhet të vijnë s’paku 20 minuta para fillimit të orarit.**

Mjeshtri (Mirëmbajtësi)i shkollës, punon nga ora **7,00 gjerë ne ora 15,00.**

Zilja e parë bie 10 minuta para fillimit të mësimit dhe sinjalizon hyrjen e nxënësve nëpër klasat e tyre. Zilja e dytë sinjalizon fillimin e mësimit. Secili nxënës ulet në vendin e vetë, në pritje të fillimit të mësimit.

Mësimdhënësit pa vonesë shkojnë në orën e mësimit. Që në fillim mësimdhënësit dhe nxënësit krijojnë atmosfer të përshtatshme për punë. Vonesat e mësimdhënësve janë të patolerushme.

Hyrje – dalje të nxënësve gjatë mësimit nuk ka. Në raste të domosdoshme vetem me lejen e mësuesit. Nxënësve, Ju ndalohet hyrja në orët e mësimit me vonesë. Nxënësi-ja, i- e cili-a është vonuar për orën mësimore do të mbetet – qëndroj në oborrin e shkollës deri sa të përfundoj ora mësimore përkatëse.

Nxënësi ka të drejtë:

f. Selicë, Tetovë

Të kryejë veprimtaritë e tij në shkollë në kushtet e qeta dhe të sigurta për jetën dhe shëndetin.

Të trajtohet me respekt, me dinjitet në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme në shkollë, pa presione, pa padrejtësira, pa fyerje, pa diskriminime, pa dhunë.

Të njihet me të drejtat dhe detyrat e tij në shkollë.

T'i sigurohet nga shkolla shërbim arsimor cilësor, sipas interesave, nevojave dhe mundësive të tij, si dhe ndihmë e posaçme për të përballuar vështirësitë e tij .

Nxënësi ka për detyrë:

Nxënësit duhet të paraqiten në shkollë me veshje të përshtatshme. Ora e ed.fizik duhet të zhvillohet me veshje sportive

Të paraqiten në shkollë duke respektuar me përpikmëri orarin e komunikuar nga mësuesi kujdestar i tyre.

Të respektojë mesuesit dhe shokët e klasës e të shkolles, dhe të kërkojë respektimin e tyre , edhe nga nxënësit e tjerë dhe mësuesit

Të respektojë rregullat e institucionit për mbrojtjen e shëndetit, të sigurisë e të mjedisit

Të vijë në shkollë i pajisur me tekste,fletore e mjete të tjera të domosdoshme.

Të mbajë qendrim të mirë dhe të mos bëhet pengesë për zhvillimin normal të orës së mësimi

Nxënësi ndalohe të përtypet gjatë orës së mësimi

Ndalohe të hyje në klasë pasi ka rënë zilja.

Ndalohe të pijë duhan, të mbajë armë zjarri apo të ftohta.

Nuk lejohet celulari në shkollë, qoftë edhe i fikur.

Nëse një nxënës largohet nga mësimi ai duhet të sjellë arsyen me shkrim të firmosur nga prindi. Për mungesa më të gjata se tre ditë për arsye shëndetsore ai duhet të ketë raportin mjeksorë. Për mungesa shumë të gjata, prindi duhet të njoftojë drejtorinë e shkolles.

Duhet te shmangjet ndotja e oborrit të shkollës, ambijenteve përreth, ndërteses, si dhe klasave.

Ndalohe të marrë pjesë në lojrat me karakter bixhozi

Ndalohe të flasë me ze të lartë në mjediset ku zhvillohet mësimi

Qeveria e nxënsëve është organizëm që mbron dhe promovon të drejtat e nxënsëve dhe ndihmon në mbarëvajtjen e shkollës

Kryetari i qeverisë së nxënsëve zgjidhet nga nxënësit me votë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.

f. Selice, Tetovë

Nxënësit janë përgjegjës për dëmtimet e shkaktuara. Në këto raste prindi duhet të përgjigjet për të gjitha shpenzimet. Nxënësit ndalohen të dalin nga klasa gjatë orëve të mësimit përveç rasteve kur i duhet të përdorin tualetet. Në këtë rast nxënësi duhet të shoqërohet.

Nxënësit nuk duhet të paraqiten në shkollë me sende me vlerë të vecante.

Këshilli i mësuesve të institucionit arsimor, i cili ka në përbërje të gjithë mësuesit dhe kryesohet nga drejtori, është organ kolegjal këshillimor për drejtimin e veprimtarisë së institucionit.

Detyrat dhe funksionet e këshillit të mësuesve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Mësuesi paraqitet në shkollë 15 minuta para fillimit të orarit mësimor të shkollës

Mësuesi mund të paraqitet në punë me vonesë ose të largohet gjatë kohës së punës vetëm me lejen e drejtorit të shkollës ose prej personit të ngarkuar prej drejtorit.

Mësuesi ka për detyrë :

Të respektojë Kodin e Etikës së mësuesit

Të zbatojë aktet ligjore e nënligjore, që janë në fuqi;

Të përkujdeset për mbarëvajtjen e çdo nxënësi të tij;

Të zbatojë rregulloren e shkollës, të cilën vetë e miraton;

Të japë ndihmesën e tij për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Të mbajë uniformën shkollore.

Të hartojë dhe të dorëzojë në afatet e caktuara kopjen origjinale të planeve mësimore vjetore me përqindjen e orëve mësimore dhe të punës edukative në drejtorinë e shkollës.

Mësuesi kujdestar i një klase është një nga mësuesit lëndor të klasës dhe caktohet nga drejtori i shkollës.

Mësuesi kujdestar e ka të ndaluar që në mbledhjet me prindërit të përmendë me emër nxënës të klasës për arritjet ose për mosarritjet e tyre. Informacioni për nxënësin i jepet vetëm prindërve të tij.

Bën kujdestarinë sipas grafikut të hartuar nga drejtoria.

Bën të gjitha përpjekjet për të realizuar orët e humbura, pavarësisht nga arsyet e humbjes.

Mësuesi paraqitet në shkollë në orën 07.15.

Mësuesit nuk i lejohet të ushtrorë dhunë fizike ose psikologjike ndaj nxënësve ose kolegëve

f. Selice, Tetovë

Të largojë nxënësin nga shkolla për ç'shtje a nevoja vetjake
Të këtë marrëdhënie me para me nxënësit ose prindërit e tyre
T'i detyrojnë nxënësit të blejnë literaturë që nuk përfshihen në katalogun vjetor të teksteve shkollore.
T'u deklarojë nxënësve bindjet e tij partiake ose fetare.
Të marrë pjesë në grupe punë që kanë me të konflikt interesi
Nuk i lejohet të përdorë shprehje ofenduese për nxënësit.
Gjatë orës së mësimit, mësuesi qëndron në klasë duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit.
Mësuesi largohet nga institucioni vetëm me miratim të drejtorit të shkollës.
Shoqëron nxënësit gjatë hyrjes dhe daljes në klasë në mëngjes shoqëron klasën që ka në kujdestari, në pushimin e madh shoqëron nxënësit me të cilët ka mësim atë orë. (Mësuesi rreshtohet bashkë me nxënësit).
Nuk i lejohet të largohet nga shkolla para orarit të përcaktuar nga kontrata kolektive e punës. Më saktë mësuesi duhet të qëndrojë në shkollë jo më pak se 40 orë në javë.
Mësuesi nuk i lejohet të mbajë ndezur celularin gjatë orës së mësimit.
Nuk i lejohet të dalë nga ora e mësimit për asnjë arsye.
Nuk ka të drejtë të nxjerrë nxënësin jashtë orës së mësimit.
Nuk i lejohet të bëjë propagandë partiake e politike ose fetare me nxënësit në mjediset e shkollës.
Mungesat e mësuesve, pa lejen me shkrim të drejtorit të shkollës ose pa dëshmi mjekesore, janë mungesa të paarsyeshme.
Për raste ose situata të veçanta të cilat nuk përfshihen në rregulloren e shkolles, drejtoria e shkolles merr vendimin adekuat.
Ankimimi i nxënësve dhe mësuesve paraqitet me shkrim, është i përshkallëzuar, duke kaluar në instancat më të larta dhe shoqërohet me kopjen e përgjigjes së instances paraadhëse. Përgjigjet për ankimimet janë me shkrim.
Me propozim të drejtorit të shkollës, të kryetarit të bordit, të këshillit të prindërve, të qeverisë së nxënësve, ose të paktën e 1/3 së mësuesve me kohë të plote, nisin procedurat për ndryshimin e neneve, ose përfshirjen e neneve të reja në rregulloren e brendshme të shkollës.
Mësuesit, nxënësit, dhe prindërit e tyre kanë të drejtë të informohen për rregulloren e brendshme të shkollës.

Drejtori ka për detyrë informimin.

Drejtori ka përgjigjesinë për respektin në shkolle të legjislacionit në fuqi dhe rregullores së brendshme të shkollës
Drejtori ka për detyrë të mbrojë të drejtat e të dhënave personale të stafit dhe të nxënësve.
Të lejojë publikimin e fotografive, videove apo filmimeve vetëm duke përdorur sfumatura në fytyrat e fëmijëve
Të mos lejojë publikimin e materialeve të mbrojtura nga "E drejta e autorit" të cilët nuk kanë marrë pëlqimin, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 35/2016

Hartimi i një marrëveshje standart ndërmjet prindit të të miturit apo personit që gëzon përgjegjësinë prindërore dhe institucionit arsimor, e cila përdoret për marrjen e pëlqimit me qëllimin e publikimit të materialeve ku janë prezent fëmijët. Mban kontakte, përmes komunikimit elektronik, me njësinë e vetëqeverisjes vendore, njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, strukturat e Shëndetit Publik, Policinë e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese për ecurinë e procesit mësimor. Mbledhjet e zakonshme zhvillohen pas orarit të mësimi.

III. Kujdestaria

Arsimtarët dhe nxënësit kujdestar dite, mbikqyrin dhe zbatojnë rendin ditor të shkollës, prej fillimit e gjerë në mbarim të orarit mësimor të punës.

Mësimdhënësit kujdestar dite, në punë duhet të vijne s'paku 20 minuta para fillimit të mësimi – punës (sipas ndërrimeve, pavarësisht orarit mësimor personal). Gjatë orarit të kujdestarisë gjithmon duhet të jenë në mesin e nxënësve, duke bashkpunuar me nxënësit kujdestar të klasës. Interesohen për mbarëvajtjen e punës në shkollë, procesit mësimor , mirësjelljen e komunitetit të shkollës dhe kujdesen për pasurin e shkollës.

Pas mbarimit të orarit mësimor në ndërrimin përkatës, mësimdhënësit kujdestar dite duhet të plotesojnë fletëkujdestarin. Në fletëkujdestari duhet të shënohet në mënyrë objektive ecuria e përgjithshme e punës mësimore në shkolle, problemet dhe veshtërsitë eventuale, mungesat dhe vonesat e arsimtarëve në punë, dëmtimet eventuale të inventarit shkollor dhe të gjitha ndodhit e tjera në shkollë.

Nxënësit kujdestar klase, vijnë në shkollë s'paku 15 minuta para fillimit të orarit mësimor. Duke bashkëpunuar me mësimdhënësit kujdestar dite, kujdesen për: inventarin e klasës, pastërtin e klasës, ajrosjen e klasës, kujdesen për mjetet mësimore, pastrojnë dërrasen e zezë etj.

Një nga punëtorët teknik mban kujdestari kohë pas kohe në oborrin e shkollës, orienton dhe udhëzon palët në mjediset ku kanë punë.

Duhani, pijet alkoolike, mjetet narkotike.

Duhani, për të gjithë (nxënësit, mësimdhënësit dhe stafin tjetër) është i ndaluar në të gjitha ambientet e brendshme të shkollës (në lokalet ku qëndrojnë nxënësit – mësonjëtoje, kabinete, bibliotekë, sallën e edukimit fizik, holin e shkollës e të ngjajshme), dhe në : aktivitete jashtëmësimore, shetitje, eskursionet, pikniqe e të ngjajshme.

Pijet alkoolike, sjellja dhe konsumimi i tyre brenda ambienteve shkollore janë të ndaluara për të gjithë komunitetin e shkollës. Konsumimi dhe sjellja në shkollë e pijeve alkoolike nuk lejohet.

E patolerushme është sjellja dhe përdorimi i lëndëve narkotike. Në rastet e tilla drejtori i shkollës njofton policinë dhe prindin e nxënësit-es.

Mjetet e forta, armët e ftohta dhe të zjarrit

Rreptësisht ndalohet arrdhja në shkollë me mjete të forta (shufra hekuri, gome, druri, boksa të hekurt etj), armë të ftohta dhe armë zjarri. Në rastet të tilla obligativisht njoftohet policia dhe merren masa të tjera ndëshkuese konform legjislacionit dhe rregullave të shkollës.

Telefonat celular : Përdorimi i telefonave celular gjatë orës së mësimit është i ndaluar, për mësimdhënësit kurse nxënësit fare mos t'i marrin në shkollë. Nëse nxënësi përdor celularin gjatë kohës sa është nëshkollë i njeiti do t'i merret dhe do t'i dorezohet prindit të tij.

Konsumimi i ushqimit në klasë : Nxënësit gjatë konsumimit të ushqimit brenda në klasë t'i respektojnë rregullat.

Nxënësit janë të obliguar të respektojnë : mësimdhënësit, stafin teknik, stafin udhëheqës, sidomos shokët dhe shoqet në paralele dhe të shkollës. Konflikti verbal apo fizik në mes të nxënësve është i patolerushëm dhe i dënueshem.

Veshjet dhe frizurat : nxënësit në shkollë nuk duhet të veshin veshje (rroba) të tejdukshme, tejet të ngushta , të shkurtëra të cilat ekspozojnë pjesë të trupit, të mbajnë frizura të cilat identifikohen me grupe dhe organizata kriminale,

Kompenzimi i dëmtimit të qëllimshëm : nëse nxënësi apo disa nxënës e dëmtojnë inventarin e shkollës qëllimshëm (në klasë, kabinet, korridor apo kudo në hapsirat tjera shkollore, kompenzimin e dëmit do ta bejë prindi përkatësisht prindërit ose paralelja (po që se nuk tregohet se kush e ka dëmtuar inventarin apo paisjen – mjetin tjetër) .

Shkolla Fillore Komunale
DREJTORI,

" RILINDJA "

f. Selicë, Tetovë